



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

PROCESVERBAL

Nr. 781 Prot.

Tiranë, më 14/04/2022

Sot, më datë 28.03.2022, ditën e premte, ora 11.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të radhës në sallën e mbledhjeve të Këshillit, thirrur nga Zëvendëskryetari, z. Alfred Balla, bazuar në nenet 164 deri 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli u mblodh në prani të 10 anëtarëve, si më poshtë:

1. Z. Alfred Balla
2. Z. Bujar Sheshi
3. Znj. Eloida Goxhi
4. Znj. Esmeralda Keshi
5. Z. Ludovik Doda
6. Znj. Mirela Bogdani
7. Znj. Nurihan Seiti
8. Z. Sokol Stojani
9. Z. Tartar Bazaj
10. Z. Zeqir Hoda

Mungon z Sandër Beci për shkak të zgjedhjes së tij si anëtar i Gjykatës Kushtetuese.

Ishin ftuar për të qenë të pranishëm përfaqësues nga projekti OPDAT, Prokurori i Përgjithshëm si dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Alfred Balla, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikoi pjesëmarrjen e anëtarëve, bëri hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kaloi në paraqitjen e rendit të ditës.

Rendi i ditës:

1. Diskutimi/miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 18 Mars 2022.
2. Zgjedhja e Kryetarit të ri të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
3. Diskutimi/miratimi i projektaktit për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Sandër Beci.
4. Diskutimi/miratimi i projektaktit për plotësimin e pozicionit të Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë përmes procedurës së komandimit.
5. Diskutimi/miratimi i projekt-raportit vjetor të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2021.

Të tjera (pyetje/diskutime).

Z. Balla pyet anëtarët, nëse kanë propozime për të shtuar ndonjë çështje tjetër në rendin e ditës.

Me propozim të znj. Seiti, për shkak të publicitetit që ka kjo seancë, z. Balla vendosi që pika e parë e rendit të ditës të jetë: “Zgjedhja e Kryetarit të ri të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Znj. Seiti merr fjalën dhe shprehet se, sipas ligjit, njëkohësisht me zgjedhjen e Kryetarit, Këshilli duhet të zgjedhë dhe zëvendëskryetarin. Në këto kushte, ajo propozon që në rendin e ditës të shtohet dhe togfjalëshi “zgjedhja e zëvendëskryetarit”.

Z. Balla përgjigjet se ky argument vlen në momentin kur të mbetet bosh vendi i zëvendëskryetarit, pra atëhere do të merret parasysh edhe propozimi i parashtruar nga znj. Seiti. Në këto kushte, ai vijon me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Zgjedhja e Kryetarit të ri të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Z. Balla shprehet se, në bazë të Rregullores së Brendshme të Këshillit, çdo anëtar i Këshillit, i zgjedhur nga Kuvendi, pra joprokuror, ka të drejtë të kandidojë për postin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Z. Balla sjell në vëmendje që Këshilli, i cili u mbledh në datën 2 mars 2022 (meqenëse mandati i z. Ibrahim kishte përfunduar), vendosi që, meqenëse u shtua me një anëtare e re (znj. Bogdani), t'u jepte kohë 5 (pesë) anëtarëve joprokurorë, të mund të shprehnin dëshirën për të kandiduar për

postin e Kryetarit të ri të Këshillit. Për këtë qëllim u caktua data 28 mars 2022, si datë e mbledhjes, kur kandidatët do të mund të shprehnin vullnetin dhe platformën e tyre për t'u zgjedhur në pozicionin e kryetarit.

Z. Balla vijon se ai personalisht ka kandiduar për këtë post, duke u shprehur se, në dijeninë e tij, nuk ka asnjë anëtar tjetër i Këshillit që të ketë kandiduar apo të ketë paraqitur platformën e tij. Sipas tij, Këshilli kishte një javë kohë për t'u njohur me vizionin e secilit kandidat.

Z. Balla vijon se, bazuar në nenin 5 të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, pika 2, germa “c”, ku përcaktohet se, “çdo anëtar i Këshillit mund të propozojë veten ose një anëtar tjetër për pozicionin e Kryetarit apo të Zëvendëskryetarit; sikurse, kandidati duhet të paraqesë vizionin e tij për pozicionin”. Gjithashtu, pas paraqitjes së propozimeve, çdo anëtar i Këshillit, para votimit, mund të japë mendimin e tij rreth njërit apo të gjithë kandidatëve të propozuar.

Z. Balla pyet anëtarët, nëse kanë ndonjë propozim tjetër në lidhje me kandidimin për Kryetarin e ri të Këshillit. Meqenëse nuk ka, atëherë ai vijon, në cilësinë e kandidatit, me prezantimin në mënyrë të përmbledhur të platformës së tij, e cila iu është dërguar paraprakisht të gjithë anëtarëve, në mënyrë elektronike.

Z. Balla shprehet se platforma e tij ka mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore të administratës së Këshillit, duke e vënë theksin tek nevoja e rifreskimit të aktivitetit administrativ, gjë që, sipas tij, do t'i jepte një energji pozitive punës së deritanishme. Ai thekson rritjen e kapaciteteve profesionale të Këshillit, të magjistratëve, të stafit administrativ të Këshillit dhe të zyrave të prokurorive, si dhe rritjen e bashkëpunimit institucional, kryesisht me Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Shkollën e Magjistraturës, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Ministrinë e Drejtësisë, duke punuar ngushtësisht dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Ai e cilëson bashkëpunimin e vërtetë dhe efikas me Prokurorin e Përgjithshëm, si pjesë të pandarë e menaxhimit dhe drejtimit të sistemit të prokurorisë. Këtë bashkëpunim ai e shikon edhe në kuadër të riorganizimit të hartës së re gjyqësore, për rrjedhojë, edhe të zyrave të prokurorive.

Z. Balla e vë theksin tek sinkronizimi i punëve, problematikave dhe shqetësimeve me zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, në interes të të gjithë sistemit të prokurorisë. Ai thekson, gjithashtu, rritjen e bashkëveprimit me KLGJ-në, për të unifikuar praktika të njëjta sjelljeje e vendimarrjeje, duke u mbledhur në mënyrë periodike jo vetëm një herë në vit. Sipas tij, kjo do të ndihmonte në radhë të parë magjistratët, për pritshmëri të njëjta nga dy Këshillat, por edhe për ndjekjen e hapave të sigurtë në karrierën e tyre.

Një pike tjetër e platformës ishte bashkëveprimi i ngushtë me Shkollën e Magjistraturës, për të mundësuar përmirësimin e kurrikulave mësimore e trajnuese, në kuadër të ndryshimeve ligjore dhe prioriteteve të sistemit; kryerjen në kohë optimale të vetingut në hyrje e dalje të shkollës, si dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të magjistratëve nëpërmjet trajnimeve vazhduese efikase dhe bashkëkohore të mirëmenduara. Për këtë qëllim, ai e vë theksin tek pjesmarrja aktive e Kryetarit të KLP-së në bordin Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, ku së bashku me Prokurorin e Përgjithshëm, ata do jenë një zë i rëndësishëm.

Duke përmendur bashkëpunimin e vazhdueshëm me Ministrinë e Drejtësisë, përsa i përket nevojës së plotësisimit apo rishikimit të kuadrit ligjor, qoftë të sistemit të prokurorisë, qoftë atij të drejtësisë në tërësi, (por edhe kuadrit të ngushtë ligjor, i cili normon punën, karrierën dhe statusin e anëtarëve të KLP-së gjatë e pas përfundimit të mandatit), ai thekson edhe bashkëveprimin e shpejtë dhe korrekt me ILD-në, në kuadër të procedimeve disiplinore dhe ndëshkueshmërisë që do ushtrohet për çdo magjistrat që dëmton imazhin e sistemit të drejtësisë dhe besimin e publikut tek ajo.

Në këtë proces, ai shprehet se do të nxisë anëtarët e Këshillit që, mbi bazën e denoncimeve të plota që vijnë nga qytetarët, të jenë ata nismëtarët e një hetimi administrativ, duke e ndjekur atë pranë ILD-së.

Z. Balla thekson, gjithashtu, mbajtjen dhe forcimin e bashkëpunimit të shkëlqyer me miqtë ndërkombëtarë, amerikanë dhe evropianë, sidomos me misionin OPDAT dhe çdo projekt të dërguar nga Bashkimi Europian, Këshilli i Europës etj.

Me partnerët ndërkombëtarë do shkëmbejmë nevojat për asistencë ligjore, teknike e bashkëpunim konkret, në kuadër të përafrimit të legjislacionit shqiptar me atë të vendeve perëndimore, thekson z. Balla, duke mos harruar të përmendë bashkëpunimin e ngushtë me çdo anëtar të Këshillit si dhe me çdo Komision të përhershëm apo të përkohshëm të tij.

Së fundmi, jo për nga rëndësia, por nga fakti që do të jetë tipar i punës së përditshme të tij, është ngritja në nivel institucional e marrëdhënieve të Këshillit me median si një pushtet që i jep frymë demokracisë në vend. Këtij trendi të ri i përket dhe puna që kemi nisur për të realizuar një nga rregulloret më të mira në vend, të bashkëpunimit me median, theksoi ai.

Z. Balla, në përfundim të prezantimit të platformës së tij, fton anëtarët, nëse kanë pyetje apo komente.

Z. Sheshi merr fjalën dhe falënderon z. Balla për nismën dhe hedhjen e kandidaturës për të drejtuar Këshillin, në një detyrë, e cila, sipas tij, nuk është një detyrë e lehtë, pasi kërkon përgjegjshmëri të lartë.

Z. Sheshi shprehet se e ka lexuar me vëmendje platformën e paraqitur nga z. Balla dhe çmon se, ajo është një platformë e plotë në aspektin formal, pasi janë trajtuar të gjitha problematikat. Por, mendon se z. Balla në këtë platformë duhet të duhet përqendrohej më shumë tek evidentimi i të metave në të kaluarën e institucionit, dhe angazhimi i tij për përmirësimin e tyre, nëse do të zgjidhej Kryetar.

Z. Sheshi vijon se Këshilli, ku ai dhe z. Balla kanë qenë në grupin e punës, ka miratuar një rregullore, të cilën, sipas tij, z. Balla nuk e ka zbatuar gjatë kësaj kohe që ka ushtruar detyrën si i komanduar në postin e Kryetarit të Këshillit.

Konkretisht, z. Sheshi i referohet një ftese për ndryshimet ligjore (që KLP duhet t'i paraqiste Kuvendit) dhe shprehet se z. Balla nuk mori asnjë mendim nga anëtarët, por e njoftoi Këshillin pas realizimit të takimit.

Z. Sheshi thekson se, për çdo aktivitet duhet të merret mendimi i anëtarëve të Këshillit si organ kolegjal, në mënyrë që ky i fundit (Këshilli) të shprehet e të vendosë se si do të procedohet më

tej. Ai e përfundon diskutimin e tij, duke shprehur keqardhje, pasi mendonte që sot Këshilli do të kishte garë mes kandidaturash për Kryetar. Në këto kushte, ai mendon se Këshillit nuk i mbetet tjetër gjë, veçse ta formalizojë këtë proces.

Z. Balla merr fjalën dhe përgjigjet se të gjitha ato çka konstatoi z. Sheshi janë të vërteta. Ai angazhohet se, nëse do të marrë votëbesimin e Këshillit si Kryetar, fryma e re që do të sjellë është pikërisht marrja e mendimit të anëtarëve, për të qenë thjesht spiker (zëdhënës) i Këshillit.

Në lidhje me takimin e përmendur nga z. Sheshi, ai shprehet se nuk kishte patur mundësi të vinte në dijeni Këshillin. Takimi në fjalë nuk kishte një axhendë, thotë ai, por ishte thjesht një takim njohës, ndaj u lanë afate kohore, me qëllim që çdo anëtar i Këshillit të japë mendimet e tij.

Z. Balla rishpreh angazhimin e tij se do të jetë bashkëpunues dhe mendimi i Këshillit do të jetë mbi gjithçka.

Znj. Seiti merr fjalën dhe shprehet se Këshilli e ka vlerësuar komoditetin ku ndodhet z. Balla, si një kandidat me përvojë 3-vjeçare në Këshill. Ajo vë në pah natyrën profesionale të anëtarëve të Këshillit, duke konstatuar se nuk ka pasur një ndarje mes anëtarëve prokurorë të zgjedhur nga trupa e prokurorëve dhe anëtarëve joprokurorë të zgjedhur nga Kuvendi.

Znj. Seiti vlerëson se fuqia e kësaj trupe (të anëtarëve prokurorë) është shumë e madhe, por kushtet janë të tilla që për postin e Kryetarit të Këshillit të kandidojnë anëtarë joprokurorë. Ajo vijon se ka disa gjëra që duhet të përmirësohen sa i takon marrëdhënies së Këshillit me magistratët, duke u shprehur se ata duhet të bashkëpunojnë me Këshillin.

Znj. Seiti e përfundon diskutimin e saj, duke bërë me dije se, të gjitha pyetjet dhe shqetësimet që ajo ka, do t'i paraqesë pas zgjedhjes së Kryetarit, me qëllim që gjërat të bëhen më mirë.

Z. Stojani merr fjalën dhe shprehet se Këshilli tregoi një maturi, përgjegjësi dhe përgjegjshmëri, kur e zgjati afatin me 3 javë, për paraqitjen e kandidaturave, në mënyrë që të njihej me vizionin e kandidatëve. Nga ana tjetër kjo u dha mundësi anëtarëve që të hiqnin çdo hije dyshimi apo çdo lloj mëdyshjeje (të secilit prej anëtarëve të Këshillit që ka të drejtën për të votuar), lidhur me faktin që, organet që e kanë pasur detyrimin për të verifikuar integritetin apo aspekte të karakterit disiplinor, e kanë bërë vendimmarrjen e tyre dhe secili prej anëtarëve potencialë të Këshillit ka kredibilitetin e duhur për të kandiduar në pozicionin e Kryetarit.

Z. Stojani argumenton se ka nevojë për ndryshime ligjore për mënyrën e zgjedhjes së Kryetarit. Duke pohuar se ligji përcakton se Kryetari duhet të jetë jomagjistrat, ai vlerëson se ky fakt i kufizon ata në zgjedhjen e Kryetarit.

Z. Stojani shprehet se e ka lexuar me vëmendje platformën e paraqitur nga z. Balla, ku ai formalisht ka trajtuar të gjitha aspektet që ka Kryetari. Megjithatë, ai mendon se ka një konfondim (paqartësi) midis kompetencave që ka Kryetari dhe ato që ka Këshilli.

Z. Stojani thekson se Këshilli është një organ kolegjal, i ndryshëm nga organet e tjera monokratike. Por, të gjitha organet funksionojnë mbi bazën e strukturave. Ai mendon se do të ishte më e qartë që z. Balla, teksa është shprehur në lidhje me një rifreskim të stafit, të kishte sqaruar se janë strukturat kompetente ato që identifikojnë problematikat që lidhen me aspektin profesional apo disiplinor, të cilat më pas ia përcjellin ato Sekretarit të Përgjithshëm, Këshillit apo Kryetarit.

Z. Stojani vijon se disa gjëra duhet të ishin shprehur më qartë, pasi z. Balla ka qenë anëtar që nga krijimi i Këshillit. Në këtë kontekst, sipas z. Stojani, në platformë duhet të ishin identifikuar problemet, pasi është normale që Këshilli, duke qenë se është një organ i ri, ka pasur problematika.

Z. Stojani thekson se në platformë duhej të evidentoheshin më mirë problematikat e vërejtura në marrëdhëniet e Këshillit me institucione të tilla, si Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm apo Ministria e Drejtësisë. Vetëm kështu do të përcaktohej se cilat do të ishin mënyrat për ta çuar më tej këtë marrëdhënie, në të mirë të sistemit të prokurorisë.

Z. Stojani mendon se duhet një ndërveprim më i mirë për ta bërë sa më funksional sistemin e prokurorisë. Ai e përfundon diskutimin e tij, duke u shprehur se Kryetari i Këshillit menaxhon, në aspektin administrativ, veprimtarinë e tij, por është dhe përfaqësues i tij.

Ashtu siç u shpreh edhe z. Sheshi, edhe z. Stojani thekson se, përpara se Kryetari të ndërmarrë veprime apo të zhvillojë takime qoftë formale apo informale, ai duhet të këshillohet me Këshillin, i cili do të përcaktojë se kush do ta përfaqësojë atë.

Z. Balla merr fjalën dhe përgjigjet se i vlerëson shumë ato që shprehu z. Stojani. Ai shprehet se, duke patur parasysh që Këshilli ka një staf administrate të vogël, kjo ka qenë dhe arsyeja që ai, në platformën e tij, ka përdorur termin “rifreskim të stafit”. Me këtë ai ka patur parasysh rritjen e numrit të tij, pasi Këshilli këtë vit do të fillojë të kryejë vlerësimin e prokurorëve.

Z. Doda merr fjalën dhe shprehet se e vlerëson nismën e z. Balla për të kandiduar në këtë pozicion. Pasi pohon se është njohur me platformën, ai konstaton që z. Balla i nje problematikat e Këshillit dhe të organit të prokurorisë.

Z. Doda është dakord me mendimet e kolegëve sa i takon qasjes që duhet të ketë Kryetari në raport me Këshillin. Ashtu siç u shpreh dhe z. Sheshi, edhe z. Doda shpreh keqardhjen që nuk pati garë për postin e Kryetarit. Në këto kushte, thekson ai, Kryetari i Këshillit, i cili përfaqëson Këshillin në marrëdhënie me të tretët, duhet të ketë një kapacitet profesional dhe integritet moral në atë shkallë që të jetë i denjë për Këshillin.

Znj. Bogdani merr fjalën dhe shprehet se, duke qenë se është një nga anëtarët joprokurorë dhe më të rinj/reja të Këshillit, ajo nuk e ndjeu veten të gatshme për të marrë pjesë në këtë garë, edhe pse vizionin e kishte.

Znj. Bogdani e vlerëson kandidimin e z. Balla, duke u shprehur se është një angazhim i madh të drejtosh një Këshill, ku 11 anëtarët e tij kanë një përvojë të madhe. Ajo e përfundon diskutimin e saj, duke u shprehur se motoja e saj është që, pasi t'i japë Këshillit, atëherë do të shohë dhe mundësinë për të kërkuar prej tij.

Z. Balla merr fjalën dhe shprehet se është i vetëdijshëm për përgjegjësinë e këtij posti, duke përmendur se nuk është e lehtë për të drejtuar Këshillin, në përbërje të të cilit janë anëtarë me një përvojë të gjatë.

Duke qenë se nuk ka komente dhe diskutime të tjera, **z. Balla** hedh në votim projektvendimin për zgjedhjen e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Miratohet me 10 vota pro.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Balla falënderon kolegët për besimin dhe zotohet që nuk do t'i zhgënjejë ata. Në vijim, z. Balla (tanimë në cilësinë e kryetarit), pyet anëtarët se si do të procedohet për zgjedhjen e zëvendëskryetarit, pasi ky pozicion tani është vakant.

Z. Stojani merr fjalën dhe propozon që, meqenëse kjo pikë nuk është në rendin e ditës, Këshilli t'u japë mundësi anëtarëve që të marrin kohën e duhur e të reflektojnë për të kandiduar.

Z. Bazaj merr fjalën dhe shprehet se, meqenëse Zëvendëskryetari është mbështetes i Kryetarit dhe bashkëpunëtor i Këshillit, duke patur parasysh që Këshilli është njohur me kandidaturat, kjo çështje të trajtohet në mbledhjen e sotme plenare.

Z. Balla sqaron se, tre kandidaturat potenciale janë: znj. Seiti, z. Bazaj dhe znj. Bogdani.

Z. Sheshi propozon që, meqenëse kjo pikë nuk është në rendin e ditës, zgjedhja e zëvendëskryetarit të shtyhet për mbledhjen e ardhshme plenare.

Znj. Goxhi shprehet se ka të njëjtin mendim si z. Sheshi.

Në këto kushte, **z. Balla** ndërpret mbledhjen plenare për një pushim të shkurtër. Ky është momenti kur media largohet.

Z. Balla rifillon mbledhjen plenare dhe vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Diskutimi/miratimi i projektaktit për deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z. Sandër Beci.

Z. Balla fton anëtarët, nëse kanë pyetje apo komente.

Z. Sheshi merr fjalën dhe shpreh falenderimet e tij për kontributin e vyer që z. Beci ka dhënë në Këshill, sidomos në cilësinë e kryetarit të komisioneve të posaçme të ngritura për zgjedhjen e prokurorëve në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Ai e vlerëson z. Beci për logjikën në vendimmarrje, për frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, duke i uruar atij suksese në detyrën e re.

Z. Stojani merr fjalën dhe i propozon Këshillit që ta bëjë traditë organizimin e një ceremonie si për largimin, ashtu dhe për zgjedhjen e një anëtari të ri në Këshill

Z. Balla fton z. Bazaj të relatojë në emër të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Z. Bazaj relatton se, Këshilli i Lartë i Prokurorisë është krijuar me Vendimin nr. 1, datë 19.12.2018 “Për krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, datë në të cilën ka filluar të ushtrojë përgjegjësitë e tij në bazë të në Kushtetutës, Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi.

Z. Bazaj referon faktin se Këshilli përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, nga të cilët gjashtë janë magjistratë prokurorë që vijnë nga Prokuroria e Përgjithshme (një përfaqësues), Prokuroritë pranë Gjykatave të Apelit (dy përfaqësues), Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë (tre përfaqësues) dhe pesë anëtarë të tjerë joprokurorë, respektivisht dy pedagogë nga Shkolla e Magjistraturës dhe Fakulteti i Drejtësisë, dy anëtarë nga fusha e Avokatisë dhe një anëtar nga Shoqëria Civile.

Sipas nenit 149, pika 10, të Kushtetutës, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë e ushtrojnë detyrën me kohë të plotë për një periudhë prej 5 vjetësh. Ndërsa, sipas nenit 149/b, pika 2, të Kushtetutës, pasi listohen rastet e mbarimit të mandatit të anëtarit të këtij Këshilli, konstatimi i mbarimit të mandatit bëhet me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Me qëllim përtëritjen e pjesshme dhe për vazhdimin normal të punës në një institucion të plotësuar me të gjithë anëtarët, në përputhje me nenin 179, pika 6, të Kushtetutës dhe nenin 279, pika 7, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në mbledhjen e parë të tij në dt. 19.12.2018, ka miratuar Vendimin nr. 4, datë 19.12.2018 “Për miratimin e Rregullores për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilët do të kenë mandat trevjeçar”, si dhe ka hedhur shortin për këtë qëllim.

Konfirmimi i kohëzgjatjes së mandatit trevjeçar dhe pesëvjeçar për secilin nga anëtarët e mësipërm është bërë me Vendimin e KLP-së nr. 213, datë 13.10.2020 “Për përlllogaritjen e mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”.

Ky vendim përcakton kohëzgjatjen e mandatit të anëtarit Sandër Beci, deri në datën 18.12.2021. Bazuar në nenin 149/b, pika 4 të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, dhe për shkak të mos zgjedhjes së anëtarit të ri të KLP-së që vjen nga radhët e pedagogëve, z. Beci e ka ushtruar këtë detyrë deri më 23.03.2022, datë në të cilën ka bërë betimin para Presidentit të Republikës, si anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të këtij fakti, Këshilli i Lartë i Prokurorisë duhet të deklarojë mbarimin e mandatit si anëtar i KLP-së, të z. Sandër Beci.

(Relacioni i plotë ndodhet në dosjen e depozituar në zyrën e protokollit).

Z. Balla fton anëtarët, nëse kanë pyetje apo komente. Meqenëse nuk ka, ai hedh në votim projektvendimin.

Miratohet me 10 vota pro.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Balla vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

3. Diskutimi/miratimi i procesverbalit të Seancës Plenare të datës 18 mars 2022.

Z. Balla pyet anëtarët, nëse kanë pyetje apo vërejtje. Meqenëse nuk ka, ai hedh në votim procesverbalin.

Miratohet me 10 vota pro.

(Procesverbali gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit)

Z. Balla vijon me pikën e katërt të rendit të ditës.

4. Diskutimi/miratimi i projektaktit për plotësimin e pozicionit të Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përmes procedurës së komandimit.

Z. Balla fton znj. Goxhi të relatojë në emër të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës.

Znj. Goxhi relaton (në cilësinë e relatores të caktuar me short) se Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, në mbledhjen e tij të datës 18.03.2022, diskutoi

çështjen në lidhje me fillimin e procedurave të komandimit për një magjistrat prokuror, i cili do të kryejë pranë Këshillit, detyrën e Këshilltarit të Etikës. Kjo detyrë është e parashikuar në ligjin Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pikën 2, pikën 4 të nenit 182, nenin 178 dhe pikën 7 të nenit 182

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vë në dukje faktin që ky pozicion tashmë është vakant që prej krijimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Gjithashtu, nisur nga fakti që tashmë Këshilli ka miratuar “Standardet e Etikës dhe Rregullat e Sjelljes së Prokurorit”, për të përmbushur detyrimet ligjore të parashikuara nga ligji, lind domosdoshmëria për fillimin e procedurave për përzgjedhjen e një prokurori në pozicionin e Këshilltarit të Etikës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Sa më sipër, Komisioni Për Zhvillimin e Karrierës arsyeton se, duke qenë hera e parë që ky funksion krijohet pranë Këshillit (pasi në përgjigje të kërkesës së parë për zgjedhjen e këshilltarit të etikës me kohë të pjesshme nuk pati asnjë kandidat), ky funksion duhet të jetë më kohë të plotë.

Për rrjedhojë, duhen zbatuar dispozitat e Ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, që lidhen me komandimin. Nga pikëpamja procedurale do të zbatohen përcaktimet e nenit 53, pika 2 të Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Znj. Goxhi vijon se, referuar nenit 54 “Procedurat e komandimit” të ligjit të sipërpërmendur, Këshilli hap një procedurë komandimi për vendin vakant të kërkuar nga vetë Këshilli, duke publikuar edhe shpalljen me kriteret dhe afatet e komandimit. (Znj. Goxhi citon kriteret dhe dokumentacionin e nevojshëm që kandidatët duhet të paraqesin për këtë pozicion).

Për sa më sipër, Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, referuar nenit 53 pika 2 dhe 54 të ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe pikës 2 të nenit 182 të ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, propozon fillimin e procedurave për plotësimin e pozicionit vakant të Këshilltarit për Etikën pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përmes procedurës së komandimit, për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh.

(Relacioni i plotë ndodhet në dosjen e depozituar në zyrën e protokollit).

Z. Balla fton anëtarët, nëse kanë pyetje apo komente. Meqenëse nuk ka, ai hedh në votim projektvendimin.

Miratohet me 10 vota pro.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Balla vijon me pikën e pestë të rendit të ditës.

5. Diskutimi/miratimi i projekt-raportit vjetor të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2021.

Z. Balla bën me dije se çdo komision i përhershëm i Këshillit ka raportuar pranë Këshillit, raportime të cilat janë bashkuar në një projekt-raport të vetëm, i cili u është shpërndarë të gjithë anëtarëve. Ai shprehet se ky raport do t'i përcillet Kuvendit, ku Kryetari i Këshillit (në një ditë caktuar) do të raportojë para Komisionit të ligjeve dhe në një seancës plenare të Kuvendit.

Z. Balla gjen rastin dhe përgëzon katër komisionet e përhershme, Komisionin për Mbrojtjen e Prokurorëve, Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave të ardhura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, si dhe komisionet e posaçme që u krijuan për zgjedhjen e prokurorëve të SPAK-ut, gjatë vitit 2021.

Z. Balla fton anëtarët, nëse kanë pyetje apo komente. Meqenëse nuk ka, ai hedh në votim projektvendimin.

Miratohet me 10 vota pro.

(Vendimi i plotë gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit).

Z. Balla falenderon anëtarët për diskutimet e tyre dhe, në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, në orën 13:10 minuta, në cilësinë e Kryetarit të sapozgjedhur, e deklaroi mbledhjen plenare të mbyllur.

Mbajtësi i procesverbalit:

Sonila Çeliku



Shënim 1:

Në këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësitë e mundshme, të konstatuara nga anëtarët e KLP-së.

Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të Kryetarit/Zv.Kryetarit, Nr. ___ Datë ___ 2022/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Nr. ___ datë ___ (bashkëlidhur kopjet e dokumenteve).

Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së, datë 13.04.2022

Procesverbali të arkivohet.

DREJTORI I DREJTORISË SË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE

Artur Lazebcu

